

## KONTRATË E PUNËDHËNËSIT PËR ANËTARËSIM NË FONDIN E PENSIONEVE VULLNETARE SIGAL KUR KONTRIBUON SË BASHKU ME PUNËMARRËSIT E TIJ

Mbështetur në nenet 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 6 dhe 53 të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensioneve Vullnetare” si dhe në nenin 3 të Rregullores nr.2 datë 13.01.2011 “Për Përmbajtjen e Kontratës dhe të Prospektit të Fondit të Pensionit”, sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_ nënshkruhet kjo kontratë me përfaqësuesit e palëve si më poshtë:

### PUNËDHËNËSI:

Z/Znj. \_\_\_\_\_ në cilësinë e punëdhënësit për punëmarrësit (i cili në nenet vijues të kësaj kontrate do të përdoret me termin Punëdhënësi), përfaqësues ligjor i subjektit \_\_\_\_\_, person juridik i regjistruar me NIPT \_\_\_\_\_, Kodi Fiskal \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_, i cili kërkon të anëtarësojë punëmarrësit e tij në Fondin e Pensioneve Vullnetare “SIGAL” për të marrë pjesë në skemën e pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara.

### DHE

### SHOQËRISË ADMINISTRUESE:

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit “SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a., me seli në Tiranë, Rr. "Donika Kastrioti", pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zviceriane (Pallati i Ri Teknoprojekt), me licencë nr. 2, datë 30.03.2011, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga **Z. Elvis PONARI**, me funksion **Administrator** i cili ka fuqi të plota për të nënshkruar këtë kontratë.

### Palët kontraktuese bien dakord si më poshtë

#### Neni 1

##### Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve të tij në Fondin e Pensionit Vullnetare “SIGAL”.

#### Neni 2

##### Qëllimi i Kontratës

Qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është anëtarësimi i punëmarrësve në Fondin e Pensioneve Vullnetare “SIGAL” dhe sigurimi me pension vullnetar i të gjithë punëmarrësve të subjektit.

#### Neni 3

##### Detyrimet e Punëdhënësit

Pjesëmarrjen në fondin e pensionit vullnetar “SIGAL”, Subjekti ua ofron të gjithë punëmarrësve me një kontratë të rregullt pune. Madhësia e kontributit të punëdhënësit përcaktohet në marrëveshjen që lidhet me përfaqësuesit e punëmarrësve sipas dispozitave të Kodit të Punës.

#### Neni 4

Në cilësinë e punëdhënësit për punëmarrësit e tij, Subjekti merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute mujore në shtesë të tyre të paguara për skemën e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore për të gjithë punëmarrësit e tij në Fondin e Pensionit Vullnetare “SIGAL”.

#### Neni 5

Punëdhënësi kryen vullnetarisht çdo muaj për muajin pasardhës, pagesën e kontributeve për sigurimin vullnetar të punëmarrësve në nivelin e përcaktuar në pjesën Aneks, që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

#### Neni 6

Punëdhënësi bën ndalesat edhe të pjesës së kontributit që punëmarrësi me dëshirën e tij merr përsipër të derdhë në Fond dhe bashkë me pjesën e tij kryen pagesën e kontributeve vullnetare brenda një afati jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë e muajit pasardhës.

#### Neni 7

Punëdhënësi pas kryerjes së pagesës mujore të kontributeve për sigurimin vullnetar të punonjësve, paraqet çdo muaj pranë SH.A.F.P “SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. listëpagesën e punonjësve, në të cilën pasqyrohet e veçantë kontributi i paguar si nga punëmarrësi, ashtu dhe nga punëdhënësi i tij.

#### Neni 8

Kontributet e paguara nga punëdhënësi, ose çdo person tjetër në favor të punëmarrësit vlerësohen si kontribute të paguara nga vetë punëmarrësi. Punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësve të vet për mos pagimin e kontributeve të parashikuara në këtë kontratë.

#### Neni 9

Punëdhënësi mund të kufizojë të drejtën e anëtarit për kontributet e dhëna nga punëdhënësi, duke kërkuar që punëmarrësi të jetë

punësuar tek punëdhënësi për një periudhë të caktuar vitesh. Periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimt të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nuk mund të jetë më e gjatë se dy vjet, filluar nga dita kur është bërë nga punëdhënësi pagesa e parë e plotë e kontributeve për sigurimin vullnetar të punëmarrësve të tij.

Kur punëdhënësi ndërpret marrëdhënien e punës me punëmarrësin, në mënyrë të njëanshme, pa shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkaqe të lidhura me punëmarrësin përpara periudhës së përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, kontributet e bëra nga punëdhënësi do t'i transferohen punëmarrësit.

#### Neni 10

Përveç detyrimeve të mësipërme, punëdhënësi detyrohet të zbatojë të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimit vullnetar në Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.

#### Neni 11

Për çdo ndryshim të numrit të punësuarve në aktivitetin e tij, punëdhënësi është i detyruar të njoftojë paraprakisht Shoqërinë Administruese të Fondit të Pensioneve. Mënyra dhe koha e kryerjes së këtij njoftimi përcaktohet me marrëveshje mes tij dhe Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensioneve.

#### Neni 12

Punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësve të vet për mospagimin e kontributit të parashikuar në kontratën individuale të anëtarësimit. Shuma e përgjegjësisë varet nga shumta e kontributeve, që nuk janë paguar ose nuk janë paguar plotësisht në fondin e pensionit, nga të ardhurat nga investimet, të parashikuara për periudhën në fjalë dhe nga çdo kosto, që mund të ketë punëmarrësi për të detyruar punëdhënësin të respektojë detyrimin e tij për të paguar kontributin.

#### Neni 13

Punëdhënësi kërkon zbatimin e plotë të të gjitha detyrimeve që i linden SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. nga zbatimi i akteve ligjore e nënligjore për administrimin e llogarive të anëtarëve, si dhe për dhënien e përfitimeve të personave të anëtarësuar.

#### Neni 14

Punëdhënësi i cili dëshiron të dalë nga Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL" është i obliguar të informojë me shkrim për këtë veprim, anëtarët e fondit, shoqërinë administruese dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të paktën 3 muaj përpara vendimit për daljen nga fondi.

Punëmarrësi vazhdon të mbetet anëtar i fondit edhe në rastet kur ka ndërprerë përkohësisht pagesën e kontributeve në llogarinë e tij personale.

Punëmarrësi ka të drejtë që të vazhdojë anëtarësimin në Fond edhe pas skadimit të periudhës për të cilën është rënë dakord, pa një njoftim të veçantë me shkrim për shoqërinë administruese dhe pa marrë parasysh nëse janë paguar rregullisht kontributet në llogarinë e tij personale.

#### Neni 15

##### Detyrimet e Fondit

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a, brenda 30 ditëve pas miratimit e nënshkrimit të Kontratës së Anëtarësimit me Punëdhënësin, lidh kontratën individuale të anëtarësimit me çdo të punësuar, ku përcaktohet edhe masa e kontributit që do të paguajë vetë i punësuar, sipas kontratës individuale të anëtarësimit të shoqërisë administruese të fondit të pensioneve.

#### Neni 16

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensioneve "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a krijon për secilin anëtar një llogari individuale në të cilën, regjistrohen të gjitha pagesat e kontributeve të bëra nga ai vetë dhe nga punëdhënësi i tij, si dhe të gjitha mjetet e tjera që grumbullohen në këtë llogari si rezultat i fitimit të ardhur nga investimi.

#### Neni 17

##### Strategjia e Investimit

Asetet e Fondit investohen në bazë të strategjisë afatgjatë të investimit të aseteve, me qëllim optimizimin e kthimit nga investimi, duke vepruar brenda nivelit të pranueshëm të rrezikut. Portofoli i Fondit do të përbëhet nga tituj afatgjatë të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Politika e investimit paraqitet në Prospektin e Fondit bashkangjitur kësaj kontrate dhe e publikuar në faqen zyrtare.

#### Neni 18

##### Vlera neto e aseteve dhe vlera e kuotave të fondit të pensionit

1. Vlera totale e aseteve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit\*, është shumta e vlerave të të gjitha llojeve të aseteve të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore dhe të përcaktuara në prospekt në përputhje me objektivat e investimit të fondit të pensionit.

2. Vlera neto e aseteve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t), rezulton nga diferenca mes vlerës totale të aseteve të fondit të pensionit, të një dite më parë (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).

3. Vlera neto e aseteve për çdo kuotë pensioni, në ditën e vlerësimit, do të llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit me numrin total të kuotave të pensionit.

4. Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit, llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit, të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për kontribuesit gjatë ditës (t-1), të cilët kanë paguar kontributet në ditën (t-1), si dhe duke zbritur numrin e kuotave të tërhequra nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, apo të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1).

5. Kuotat e pensionit të emetuara dhe të tërhequra nga fondi i pensionit regjistrohen në llogaritë personale të anëtarëve të fondit në të njëjtën ditë të emetimit apo tërheqjes.

*\*"Ditë vlerësimi"- nënkupton ditën "t" në të cilën bëhet përlllogaritja e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit mbështetur në të dhënat e mbylljes së një dite më parë "t-1".*

#### Neni 19

1. Shoqëria administruese, në periudha të rregullta kohore dhe të paktën çdo 30 ditë, informon anëtarin për asetet, përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aseteve në llogarinë e pensionit të anëtarit, datat e kontributeve dhe transferimet e aseteve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve e të aseteve në kuota pensioni. Shoqëria administruese është përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit për çdo anëtar. Mënyrat e informimit janë me shkrim dhe/ose elektronikisht. Anëtarit pajiset me kartën personale të anëtarësisë me të cilën do të ketë mundësi të informohet mbi gjendjen e aseteve në çdo kohë.

2. Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a, informon në çdo moment anëtarët për politikën e investimit si dhe për ndryshimet në veprimtarinë që ndikon në të ardhurat e tyre, kjo jo vetëm nëpërmjet faqes së Fondit, por edhe në informacionet individuale që ju dërgojmë rregullisht çdo anëtar të fondit.

#### Neni 20

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. publikon në mënyrë dhe afate kohore të

përcaktuara në ligj, raportin vjetor të kompanisë, të ardhurat e fondit, vlerën e njësive të investimeve, normën e fitimit, etj.

#### Neni 21

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. merr përsipër të informojë Punëdhënësin për ndryshimet që do të kenë dispozitat, rregulloret e tarifave të Fondit të Pensionit Vullnetar "SIGAL".

#### Neni 22 Zbatimi i tarifave

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. merr përsipër të njoftojë tarifat e pjesëmarrjes dhe të shërbimit të Fondit të Pensionit dhe çdo anëtar i anëtarësuar në fond.

Çdo rritje e tarifave të zbatuara nga SH.A.F.P. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. do t'u njoftohet anëtarëve, të paktën dymbëdhjetë muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

#### Neni 23

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA", sh.a. në zbatim të ligjit në fuqi për Fondet e Pensioneve Vullnetare, do të zbatojë këto tarifa :

a) për koston e administrimit të fondit të pensionit, deri në masën 2.2% (dy pikë dy) të vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit;

b) për transferimin e aseteve të anëtarit nga fondi i pensionit ekzistues në një fond të ri pensioni, aplikohet tarifa 0,5% (zero pikë pesë përqind) e totalit të aseteve.

c) për tërheqjet e parakohshme të aseteve, anëtarët e fondit të pensioneve do të paguajnë penalitete si më poshtë:

- 2 % të aseteve të tërhequra pas 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë
- 5 % të aseteve të tërhequra pas 10 deri 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë
- 10 % të aseteve të tërhequra pas 5 deri 10 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë
- 15 % të aseteve të tërhequra deri 5 vjet nga dita e pagesës së parë të kontributeve

Penalitetet e tërheqjes së parakohshme nuk do të aplikohen ndaj anëtarëve, të cilët kalojnë në një fond tjetër të pensionit vullnetar.

#### Neni 24 Favorizimet Fiskale

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional, në zbatim të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" konsiderohen shpenzim operativ dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

Për SH.A.F.P. "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA"

**ADMINISTRATOR**  
**Elvis PONARI**

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

#### Neni 25 Dispozita të Përbashkëta

Nëse secila nga palët nënshkruese të kësaj kontrate kërkon të tërhiqet nga zbatimi i saj, atëherë ajo është e detyruar të njoftojë palën tjetër brenda një afati jo më pak se tre muaj nga data që ka vendosur të tërhiqet.

#### Neni 26

Nëse tërheqja nga zbatimi i kontratës vjen si rezultat i shkrirjes, i bashkimit, i ndarjes, apo i mbylljes së aktivitetit të secilës palë nënshkruese, atëherë për kompensimin e pjesëmarrësve, të cilët nuk ishin shkaktarë të ndërprerjes së kontratës referimi do të bëhet në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 27

##### Kufizimet e sanksioneve dhe klauzola përjashtuese

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë pensioni nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzolë gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve të tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor."

#### Neni 28

##### Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo kontratë do të fillojë në datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët, fiton efekte ligjore me pagesën e kontributeve nga punëdhënësi dhe mbyllet brenda afatit kohor të caktuar në kontratë.

#### Neni 29

##### Ndryshimet e Kontratës

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj kontrate mund të arrihen vetëm me miratimin e dy palëve kontraktuese, pasi më parë të jetë marrë miratimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

#### Neni 30

##### Ndërprerja e kontratës

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, bëhet me mirëkuptim midis palëve, ose në rast të kundërt, çdo palë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës se rrethit gjyqësor.

#### Neni 31

##### Hyrja në Fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët.

**SUBJEKTI**

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)